



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 17 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 17 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2026, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësitë Kadastrale parcelat: P-71712027-00706-0 dhe P-71712027-00704-0, me sipërfaqe të përgjithshme 9937m², nga kjo sipërfaqe jepen në shfrytëzim 5500m², Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme.

Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës sipas vendimit përkatës për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësitë kadastrale parcelat: P-71712027-00706-0 dhe P-71712027-00704-0, me sipërfaqe të përgjithshme 9937 m², nga kjo sipërfaqe jepen në shfrytëzim 5500 m², pronë e Komunës, në këtë përbërje:

1. **z.Bahri Selimi**, nga Ekzekutivi i Komunës
2. **znj.Arbnorë Uka-Osmeni**, nga Ekzekutivi i Komunës
3. **z.Artrit Mulliqi**, nga Kuvendi i Komunës
4. **znj.Rinesa Goxhufi**, nga Kuvendi i Komunës
5. **znj.Selvete Sejdiu**, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e Vendimit nr.prot.01-463/06-0019201/26 datë 31 mars 2026 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-020/04-0019205/26
Podujevë, datë; 31 mars 2026

